



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 1732 prot.

Tiranë, më 20.04.2026

Lënda: Për propozimin e kandidaturës për Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**Drejtuar: Zotit Niko PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT**

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar si dhe në zbatim të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi me vendimin nr. 60/2018, datë 05.04.2018, zgjodhi Z. Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Mandati i tij, sipas afateve të përcaktuara në ligj, përfundoi në datën 05.04.2023.

Në zbatim të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit dhe 23, 24 dhe 30 të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, me vendimin e tij nr. 3, datë 03.03.2026, rishpalli vakancën për pozicionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe publikoi në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë njoftimin zyrtar.

Kuvendi zhvilloi një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent, duke ftuar çdo individ që plotësonte kriteret ligjore që të kandidojë për pozicionin vakant.


Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të përcaktuar në shpallje, u krye procedura e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve ligjore në bazë të dokumentacionit të sjellë nga kandidatët dhe u vlerësua se kandidaturat për pozicionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë në përputhje me kërkesat ligjore.


Referuar prezantimit të bërë nga kandidatët në seancat dëgjimore publike të zhvilluara, ne, një grup prej 28 deputetesh, pasi u njohëm me përvojën profesionale, meritën e kandidatëve dhe vizionin e tyre, i propozojmë Kuvendit të Shqipërisë kandidaturën e **znj. Genta Tafa**, për t'u zgjedhur Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi.


Ne vlerësojmë se kandidatura e propozuar, me përvojën e saj profesionale në fushën e ligjit si si dhe me aftësitë e spikatura në ushtrim të profesionit, gëzon besimin e të gjithë deputetëve dhe plotëson të gjitha kriteret që kërkon ligji.


Duke ju falenderuar për vëmendjen tuaj,


DEPUTETËT


1. Taulant Balla 


2. Kidrina Zaka 


3. SAIMIR HASALLA 


4. ERION MALAJ 


5. AMION KURDI 


6. Julona Zylykbashi 


7. Antonia Ahemp 


8. Ilva Gjeçi 


9. Ara Nako 


10. Asli Doo 


11. Alma Selami Delar 


12. Ajron Gaxho 


13. Bledi Como 

14. Elton KRESHTI 


15. Akend Bolla 


16. Zegjine Caushi ~~Caushi~~ 


17. Elvis Jusli 


18. Rube Konom 


19. SARA MICA 

20. Admir Kadeli 

21. Ego Mili 

22. Hatixhe Konomi 

23. Etleva Budimi 

24. Klevis Jahaj 

25. Genki Lokkari

26. Puro Dhimo

27. Fadhil Masufi

28. Puro Ilo

29. Besa Soso

30. Zamira Simoy

31. Amalda Rakipi